



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



Emërtimi i lëndës: Gjuhë C 3

Titullari / pedagogu i lëndës: Dr. Ela Vasi

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 0 leksione / 40 seminare

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti II / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor pranë Departamenteve të tjera FGJH

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: ela.vasi@unitir.edu.al

OBJEKTIVAT E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon të aftësojë studentin në një nivel mbi mesataren të gjuhës italiane. Percorso Italia. Niveli B 1 bën të mundur familjarizimin me strukturat e italishtes dhe përputhet me parametrat e vendosura sipas kuadrit të Bashkimit Europian të gjuhëve.

Në këtë kurs do të zhvillohen :

1. Ushtrime në CD, lexime dhe shkrime gjuhësore me karakter sociolinguistic si dhe ushtrime plotësuese.
2. Ushtrime dhe praktikë mbi komunikimin në grup.
3. Lexime jashtë teksteve të ofruara nga metoda.
4. Ushtrime mbi katër njësitë kryesore të gjuhës: dëgjimi, komunikimi, leximi dhe shkrimi.

Rezultatet e të nxënit:

Lënda ofron aftësinë për të përvetësuar koncepte të nivelit B 1 në italisht . Kjo veprimtari, përfshin fusha të tilla, si: gramatika, drejtshkrimi, drejtshqiptimi, fjalori. Lënda përftohet përgjatë kursit semestral akademik. Ajo ofron gjithashtu aftësinë për të komunikuar në gjuhën italiane; për t'u orientuar, kërkuar, përshkruar e dialoguar individualisht, apo ne grup; lënda u ofron studentëve një komunikim dhe socializim të thjeshtë në një ambient ku flitet gjuha italiane. Gjithashtu lënda përcjell tek studentët aftësinë e të qenit kreativë, duke debatuar, mbështetur dhe arsyetuar në mënyrë kritike dhe autokritike në gjuhën italiane, ky nivel përcjell informacion të larmishëm në auditor, i cili shpesh kapërcen dhe tipologjinë tematike te metodes në fjalë; aftësia për të vlerësuar dhe vetvlerësuar, bashkshoqëron dhe aftësinë për të rrëfyer ndodhi të së shkuarës, për të konsultuar informacione te ndryshme ne faqe web, apo njoftime nëpër gazeta e revista duke zgjeruar kështu linjën e njohurive dhe angazhimeve akademike përmes gjuhës së huaj të dytë; në fund, lënda përcjell mesazhin e familjarizimit dhe përdorimit të teknikave e dimensioneve gjuhësore në procesin e të mësuarit dhe të të nxënit.